



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Variante të gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite, 20 orë leksione, 20 orë seminare

Viti / Semestri: Viti II, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Angleze

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon të pajisë studentët me njohuri themelore mbi variantet e gjuhës angleze dhe variacionin gjuhësor në kuadër të teorive të gjeolingusitikës dhe sociolinguistikës. Ajo synon gjithashtu të aftësojë studentët për përdorimin korrekt të këtyre varianteve në praktikë dhe të nxisë përdorimin e burimeve si fjalorët dhe tekstet standarde për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave gjuhësore në mënyrë të pavarur.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohin dhe analizojnë variantet kryesore të gjuhës angleze (si anglishtja britanike, amerikane, australiane, etj.) në kontekstin e gjeolingustikës dhe sociolinguistikës.
2. Të dallojnë dhe interpretojnë faktorët socialë, gjeografikë dhe kulturorë që ndikojnë në variacionin gjuhësor të anglishtes.
3. Të zbatojnë në praktikë njohuritë e fituara për variantet e gjuhës, përmes përdorimit të fjalorëve, korpuseve dhe teksteve standarde, me synim zhvillimin e kompetencës së tyre komunikuese në mënyrë të pavarur dhe kontekstuale

Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do të jenë të aftë të:

1. kenë një njohje të mirë të variacionit gjuhësor dhe kulturor me të cilën lidhet zhvillimi dhe përdorimi i gjuhës angleze;
2. kenë një njohje të mirë të ndryshimeve semantike, leksikore, gramatikore, fonetike dhe stilistikore midis anglishtes britanike dhe amerikane, si dhe të varianteve të tjera të gjuhës angleze;
3. kenë një panoramë më të gjerë për kulturën dhe shoqërinë britanike dhe amerikane, australiane, etj. sipas dallimeve gjuhësore të trajtuara;
4. përmirësojnë nivelin e tyre të përvetësimit të gjuhës në tërësinë e varianteve të gjuhës angleze; analizojnë tekste, pjesëza dëgjimore të ndryshme britanike, amerikane, etj. sipas veçorive gjuhësore.